


**PORTOFOL MIKS**

mundëson një balancë midis riskut dhe përfitimit

**DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE**

për fondet në monedhë të huaj

**TREGJE NDËRKOMBËTARE**

Pjesëmarrje në tregjet e huaja të aksioneve/ obligacioneve



# RAIFFEISEN MIKS

Jepi larmi investimit tënd

## Raport Mujor Maj 2026

### Informacion bazë

Emri i Fondit	<b>Raiffeisen MIKS</b>
Administrimi i Fondit	<b>Raiffeisen Invest sh.a</b>
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma minimale e investimit	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	<b>EUR 4,559,437</b>
Cmimi i kuotës	<b>116.2258</b>
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Numri i Investitorëve	125
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Maj 2026	<b>+8.98%</b>

### Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.52% per vitin 2025 ne 31.12.2025
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne degjet e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

### Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetëz butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


## Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




**Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.**

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

## Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet. Obligacionet janë të investuara 30.4% në tituj borxhi dhe fonde investimi me risk krediti të lartë (high-yield), ku 28% i përkasin titujve të Qeverisë Shqiptare, si dhe 30.8% në obligacione dhe fonde investimi me risk krediti të ulët (investment-grade).


Alokimi në aksione (35.9%) është kryer në tregje të zhvilluara: SHBA 19.9%; Zona Euro 8.6%, Britani e Madhe 1.7% dhe Japoni 4.4% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është rritur në 2.9% në fund të muajit maj.

## Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri pozitive mujore prej **2.45%** gjatë muajit maj, duke shënuar një nga performancat më të mira mujore për këtë vit. Obligacionet përjetuan luhatshmëri të forta, megjithatë, perspektiva e tejkallimit të fazës më të vështirë të krizës energjitike ndihmoi në uljen e yield-eve.


Tregjet e aksioneve u karakterizuan nga një rritje e fuqishme, të nxitura nga fitimet e larta të korporatave dhe investimet në inteligjencën artificiale. Performanca e tregjeve financiare pati një ndikim pozitiv në portofolin e investimeve të fondit Raiffeisen Miks, i cili shënoi fitime gjatë muajit.

Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit është 3.41% për një kohëzgjatje mesatare prej 3.22 vjet më 31 maj.  
**Kthimi neto vjetor i fondit është +8.98% më 31 maj 2026.**



Ne dt 31 maj 2026	1 Vit	2 Vite	3 Vite	5 Vite	Nga lancimi (16 Dhjetor 2020)
Return in % p.a. for the period	+8.98%	+7.04%	7.38%	2.82%	+2.79%

### Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Miks per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varësi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshme e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudhë afatmesme apo afatgjatë të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat jo të zakonshme të krijuara perkohesisht në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

## Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Maj

Indeksi i çmimeve të konsumit në SHBA u rrit me 0.6% në terma mujorë në prill, duke e çuar normën vjetore të inflacionit në nivelin 3.8%. Inflacioni bazë u rrit me 0.4% në baza mujore dhe 2.8% në baza vjetore, duke treguar se presionet inflacioniste mbeten dukshëm mbi objektivin prej 2% të vendosur nga Rezerva Federale, ndërsa rritja mujore ishte më e larta që nga janari 2025.

Në Eurozonë, inflacioni vjetor arriti në nivelin 3.2% në muajin maj, duke shënuar kështu rritje krahasuar me nivelin 3.0% të regjistruar në prill. Kontributin kryesor në këtë përshpejtim e dha sektori i energjisë, ku çmimet u rritën me 10.9%. Edhe inflacioni bazë u përshpejtua, duke arritur në nivelin 2.5% në baza vjetore, krahasuar me 2.2% në muajin prill.

Në këtë mjedis, pritet që Rezerva Federale të mbajë të pandryshuara normat e interesit derisa perspektiva ekonomike të bëhet më e qartë, megjithëse retorika e saj po anon drejt një qëndrimi më pak stimulues. Nga ana tjetër, një rritje e normave të interesit nga Banka Qendrore Evropiane në muajin qershor vijon të konsiderohet pothuaj e sigurt, me synimin për të luftuar pritshmëritë mbi inflacionin.

Tregjet financiare ruajtën një ecuri pozitive gjatë muajit maj, ndërsa investitorët vazhduan të reflektonin pritshmëritë për zbutje të tensioneve gjeopolitike. Në fund të muajit u shfaqën përprjekje të besueshme për arritjen e një marrëveshjeje mes SHBA-së dhe Iranit. Megjithëse negociatat vazhduan deri në fund të muajit, probabiliteti i një zgjidhjeje të konfliktit u perceptua si relativisht i lartë. Si rezultat, çmimet e naftës ranë ndjeshëm, duke zbritur nën nivelin e 100 \$ për fuçi, pasi për pjesën më të madhe të muajit kishin qëndruar në mbi 110\$ për fuçi.

Instrumentet si obligacionet përjetuan luhatshmëri të forta, si pasojë e pasigurisë lidhur me ndikimin që konflikti në Lindjen e Mesme mund të ketë mbi rritjen ekonomike dhe inflacionin. Megjithatë, perspektiva e tejkalimit të fazës më të vështirë të krizës energjitike ndihmoi në uljen e yield-eve, pas rritjes së konsiderueshme të tyre në fillim të muajit. Si pasojë, indeksi Bloomberg Global Aggregate e mbylli muajin me një kthim pozitiv modest prej 0.3%.

Tregjet e aksioneve u karakterizuan nga një rritje e fuqishme, të nxitura nga fitimet e larta të korporatave dhe investimet në inteligjencën artificiale. Aksionet shënuan fitime në nivel global, me indeksin amerikan S&P 500 që regjistroi disa javë radhazi në territor pozitiv, ndërsa NASDAQ vijoi performancën e fortë të nisur që në fillim të vitit. Sezoni i rezultateve financiare për tremujorin e parë u mbyll me grupin e kompanive të njohura si “Magnificent Seven”, të cilat raportuan një rritje mesatare të fitimit për aksion prej rreth 63% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke tejkaluar ndjeshëm pjesën tjetër të tregut. Në Europë, performanca e tregut të aksioneve ishte më e moderuar, duke reflektuar rreziqet e vazhdueshme që lidhen me situatën në Lindjen e Mesme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sha., në web site [www.raiffeisen-invest.al](http://www.raiffeisen-invest.al) ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.